

Përkrahje investive për kërkesa individuale dhe të sektorit privat në Komunen e Hanit të Elezit, për vitin 2021

30.04.2021

Subjekti i thirrjes është:

1. Përkrahje e kërkesave individuale në sektorin e agropylltarisë, për themelimin e bizneseve të reja familjare, ose zgjerimin e atyre egzistuese.
2. Përkrahje e propozimeve inovative me bashkëfinancim për bizneset në sektorin privat, që operojnë me sukses në Komunën e Hanit të Elezit, në rritjen dhe modernizimin e kapaciteteve operative prodhuese/shërbyese egzistuese dhe propozimet individuale, në themelimin e bizneseve të reja që kontribuojnë në përmirësimin e situates socio ekonomike të komunitetit.

Aprovimi i përkrahjeve bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara nga donatori Titan Group – Sharrcem sh.p.k, ligjet e aplikueshme dhe rregullat interne të Organizatës “LAB”.

Kërkesat për **piken 1** për investime në sektorin e agropylltarisë, mund ti parashtrijnë të gjithë fermerët nga Komuna e Hani të Elezit. Shuma maksimale e mbështetjes është 70% e kostos direkte të investimeve për themelimin e bizneseve të reja, ose zgjerimin e atyre egzistuese. Ndërkaq për **piken 2** propozimet inovative me bashkëfinancim, mund ti parashtrijnë të gjithë operatorët privat që kanë bizneset e tyre aktive dhe operojnë në Komunën e Hanit të Elezit për ngritjen dhe modernizimin e kapaciteteve operative egzistuese dhe propozimet individuale në themelimin e bizneseve të reja inovative. Shuma maksimale e mbështetjes investive e pranueshme është deri në 50%, (një vlerë maksimale deri në 25,000.00€).

Përfituesi i grantit duhet ta ketë seline dhe biznesin e regjistruar në zonën e Komunës së Hani të Elezit dhe investimi gjithashtu duhet të bëhet në këtë zonë.

Si të aplikohet?

Individët e interesuar për investime në sektorin e agropylltarisë pika 1 dhe 2 me bashkëfinancim për operatorët privat në ngritjen dhe modernizimin e kapaciteteve operative egzistuese, si dhe individët e interesuar privat, për themelimin e bizneseve të reja inovative, mund të shkarkojnë format për plotësimin e aplikacioneve nga web faqja e LAB-it www.lab-ks.org, ose ti marrin ato personalisht në zyrat e LAB-it e cila gjendet në Rr. “Adem Jashari” nr. 218 - Hani i Elezit.

Afatet

Aplikacionet e kompletuara me dëshmitë (anexet e bashkangjitura), mund të dërgohen përmes e-mailit në adresën hysen.shabanaj@lab-ks.org, ose të dorëzohen direkt në zyrat tona, duke filluar nga data e publikimit të thirrjes **30.04.2021** deri me datë **31.05.2021**. Vetëm aplikacionet e kompletuara do të konsiderohen për vlerësim.

Konfirmimi i pranimit të aplikacionit bëhet më së largu tri ditë pas pranimit të aplikimit përmes e-mailit ose menjëherë pas dorëzimit të kërkesës në zyrat tona. Nëse një konfirmim i tillë nuk është marrë në këto afate kohore, ju lutem na kontaktoni duke na shkruar në adresën tonë të e-mailit ose përmes telefonit **+383 290 385 500** lokali **1120**.

Kandidatët do të informohen për rezultatet e vlerësimit me e-mail, dhe përmes publikimit të listës së përfitueseve në web faqen e LAB – it dhe në tabelen e shpalljeve publike në objektin e Komunës së Hanit të Elezit.

Nëse keni ndonjë pyetje shtesë në lidhje me thirrjen, ju lutem na kontaktoni përmes e-mailit në adresën hysen.shabanaj@lab-ks.org.

Na ndihmoni duke ndarë këtë informatë me të gjithë të njohurit tuaj!

Sektorët të cilët do të përkrahen:**1. Serra**

Objekti: Rritja e kapaciteteve prodhuese për kultivim të perim kulturave në Serra, për zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese ose themelimin e aktiviteteve të reja prodhuese në sektoret që do të mbështeten në vitin 2021.

Titulli: Furnizim me Serra të tipit “Bllok” me sipërfaqe prej 500 m², farëra, fidane dhe inpute tjera përcjellëse, deri në dy përfitues/e.

2. Bletari

Objekti: Furnizimi me paisje dhe inpute tjera përcjellëse të domosdoshme, të cilat ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së mirëmbajtjes, prodhimit dhe ruajtjes së mjaltit që përmbushin standardet e ushqimit.

Titulli: Furnizimin me paisje të domosdoshme për mirëmbajtjen dhe rritjen e Bletishteve.

3. Ngritja e plantacioneve të Lajthisë

Objekti: Themelimi i plantacioneve intenzive për kultivimin e Lajthisë me kultivar të cilat kanë fruta cilësor, produktivitet të lartë dhe posedojnë nivel të rritur të rezistencës ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve.

Titulli: Furnizimi me fidane, sistem të ujitjes dhe rrethojë për mbrojtjen e 0,4 ha sipërfaqe të plantacioneve me Lajthi.

4. Përkrahja e ideve inovative për sektorin privat dhe propozimet individuale

Objekti: Përkrahje e propozimeve të ndryshme inovative me bashkëfinancim për operatorët ekonomik privat, që operojnë në Komunën e Hanit të Elezit në ngritjen dhe modernizimin e kapaciteteve operative egzistuese dhe propozimet individuale në themelimin e bizneseve të reja inovative. Shuma maksimale e mbështetjes investive e pranueshme është deri në 50% (një vlerë maksimale deri në 25,000.00€).